



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 17, 40.2 shkronja (a), Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048 neni 17 paragrafi 1 dhe 2, Rregullorja Financiare Nr.01/2013-MF – Shpenzimi i Parave Publike neni 36 pika 3, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.4240/2023 neni 24, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15.1 shkronja (a), Kuvendi i Komunës me datën 30.09.2024 miratoi:

## PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

### Neni 7

#### Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

7.4 . Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 5 anëtarëve, dy nga drejtoria përkatëse, një zyrtar financiar, një nga një drejtori apo sektor tjetër, dhe një nga shoqëria civile.

### Neni 14

#### Subvencionet për arsim

14.2. Kategoritë dhe shumat e subvencioneve për bursa do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës, për çdo vit fiskal si dhe shumat tjera ipen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.

### Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Këto ndryshime do të inkorporohen në rregulloren për Kushtet, Kriteret Dhe Procedurat E Ndarjes Së Subvencioneve.

Hani i Elezit  
Data: 30.09.2024

